

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës – kolegji i përbërë nga gjyqtarët Gani Zabeli, kryetar kolegji, Shqipe Qerimi dhe Afrim Shala, anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Shaban Prekalla, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit F.U., nga Peja, për shkak të veprës penale mashtrimi, nga neni 335 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me ankesën e të akuzuarit F.U., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë P.nr.998/2017 datë 11.01.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur datë 18.03.2019, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e të akuzuarit F.U., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, P.nr.998/2017 datë 11.01.2018, **vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Pejë, me aktgjykimin P.nr.998/2017 datë 11.01.2018, të akuzuarin F.U., e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale mashtrimi, nga neni 335 par.1 të KPRK-së, për të cilën e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 120 (njëqind e njëzet) ditësh, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i akuzuari në afat prej 1 viti nuk kryen vepër të re penale. I akuzuari është i obliguar që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale në emër të paushallit gjyqësor në shumën prej 50 €, ndërsa në emër të kompensimit të viktimave shumën prej 30 €, e të gjitha këto në afat prej 30 ditësh, pas plotfuqishmëris së aktgjykimit. I dëmtuari S.H., për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur i akuzuari F.U., për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë, ankesën e tij ta aprovojë si të bazuar dhe i njëjti të lirohet nga përgjegjësia penale apo lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

Prokurori i Apelit, me shkresën PPA/II.nr.216/2019 datë. 04.03.2019, ka propozuar që të refuzohet si e pa bazuar ankesa e të akuzuarit F.U., ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioi aktgjykimin e kundërshtuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP, dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

- Ankesa është e pa bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj edhe në këtë aspekt, konform dispozitës së nenit 394 të KPPK-së dhe konstatoj se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij, si dhe as shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit.

Sa i përket vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, i akuzuari me ankesë pretendon se fillimisht aktakuza nga Prokuroria Themelore në Pejë e gjithashtu edhe aktgjykimi i ankimuar është në tërësi i pabazuar, ngase aktgjykimi i ankimuar nuk është i bazuar në asnjë provë materiale e cila në mënyrë të bindshme do të vërtetonte dyshimin e bazuar mirë se i akuzuari e ka kryer veprën penale. Sipas ankesës, dëshmitari- kinse i dëmtuari S.H. pretendon se tani i akuzuari të dëmtuarin e ka mashtruar, duke theksuar se tani i akuzuari edhe pse i ka porositur këto tiketa, nuk i ka paguar. I akuzuari në ankesë thekson se është e vërtetë se gjatë ditës ai ka luajtur tiketa sportive në atë bastore dhe se të njëjtat tiketa i ka paguar, e nuk është e vërtetë se i ka porositur të njëjtat tiketa dhe të mos jenë paguar. Është rregull i përgjithshëm i punës së bastoreve sportive të cilat së pari duhet të marrin pagesën për tiketë, e më pastaj t'ia japin tiketën klientit si dhe është e pa kuptim që të njëjtit të lëshojnë tiketë sportive në llogarinë e tij pa e paguar. Sipas të akuzuarit, atij asnjëherë nuk i ka ndodhur që të merr tiketën sportive pa e paguar, e aq më tepër pasi që ka kërkuar që për tani të akuzuarin, tani i dëmtuari të shtyp një tiketë në shumë prej 1300 € dhe dy të tjera nga 300 €, që në total kanë vlerën prej 1900 €. Sipas të akuzuarit, nga deklarata e dëshmitarit A.N., e dhënë 4 ditë pasi që pretendohet se kinse i akuzuari ka kryer këtë veprim, tani i njëjti deklaroi se shumën prej 900 €, kinse e ka paguar pasi ka shkuar në lokal në ora 20:40. Sipas deklaratës së dëshmitarit S.H., se i akuzuari shumën prej 900 €, e ka paguar gjatë ditës kur ka luajtur, pra cili është veprimi i të njëjtit që e paska kryer në dëm të pasurisë së të dëmtuarit S., e që sipas tij këto tiketa nuk i ka luajtur. Po ashtu i akuzuari në ankesë ka theksuar se, kinse i dëmtuari, është dashur që prokurorisë së shtetit fillimisht ti ofroj prova bindëse sikurse do të ishte nxjerrja e tabelave financiare se sa ka qenë qarkullimi ditor atë ditë, se a është paguar obligimi tatimor për këtë shumë, apo është ndonjë dëshmitar tjetër i cili do të mund të vërtetonte se i akuzuari atë natë paska luajtur në ato shuma të hollave. Sipas të akuzuarit është praktikë e përgjithshme, nëse një shumë e të hollave nuk do të paguhet, i dëmtuari ka mundur që këto tiketa sportive ti anulonte, e sipas tij këto tiketa ai nuk i ka porositur. Më tej i akuzuari në ankesë thekson se gjykata e shkallës së parë ka bërë vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike, kur i besoi deklaratës së të dëmtuarit, për arsye se po të ishin të vërteta pretendimet e tija, sigurisht nuk do të lajmronte rastin pas një muaji, por do ta bënte natën kur pretendon se është mashtruar nga ai, se nuk është e vërtetë as pretendimi i të dëmtuarit që ka biseduar me prindin e të akuzuarit as me vëllaun e tij lidhur me këtë

problem, pasi që të njëjtit nuk e njohin të dëmtuarin dhe asnjëherë nuk kanë biseduar me të lidhur për këtë çështje. I akuzuari në ankesë thekson se ai ishte në lokal duke luajtur me tiketa dhe ato tiketa i kishte paguar, por dëshmitari A.N. nuk ka qenë fare aty në lokal, ndërsa gjykata e shkallës së parë, administroj si provë materiale tre tiketat e shtypura si dhe të njëjtave iu ka falur besimin se kinse janë porositur nga ai, e në ditën kritike ai ka luajtur në vlerë prej 1700 €, dhe të njëjtat tiketa ai i ka paguar dhe është larguar. Mirëpo sipas tij gjykata e shkallës së parë nuk e ka pa të arsyeshme që nga i dëmtuari, të kërkoj prova më bindëse, përkatësisht a ka shikuar se më të vërtetë këto tiketa a kanë qenë të regjistruara dikund në librat tatimore dhe a është kryer obligimi tatimor për të njëjtat, në atë mënyrë që të konstatojë dhe të vërtetojë faktin se i dëmtuari S.H. a është dëmtuar kur ai thotë se këto të holla është dashur t'ia kthej shefit të tij. Po ashtu në ankesë i akuzuari pretendon se nuk ka ndonjë xhirim nga lokali që do të vërtetojë se në kohën e pretenduar a ka qenë i akuzuari në lokal dhe a i ka shtypur ato tiketa dhe do ta vërtetojnë se nuk i ka paguar, nga dëgjimi i pronarit të lokalit do të vërtetohet fakti se a është bërë pagesa nga ana e të dëmtuarit S.H. në llogarin e tij, pra gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë gjendjen faktike.

Gjykata e Apelit gjen se këto pretendime ankimore të akuzuarit, nuk qëndrojnë, ngase sipas shkresave të çështjes edhe gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe se kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se në këtë drejtim asnjë fakt nuk ka ngelur në mëdyshje sikurse që pa të drejt pretendohet në ankesën e ushtruar nga ana e të akuzuarit. Se i akuzuari, ka kryer veprën penale mashtrimi nga neni 335 par.1 të KPRK-së, pasi që i akuzuari nuk e ka pranuar fajësinë në procedurën e provave, gjykata e shkallës së parë ka bërë administrimin e provave, ka marrë deklaratën e të dëmtuarit në cilësi të dëshmitarit S.H. si dhe dëshmitarin A.N.. Nga provat materiale si tiketat e shtypura në shumën prej 1.300,00 €, të datës 14.05.2016, në ora 20.44:55. si dhe tiketa e shtypur Livë Bastë me numër serik 37213 të datës 14.05.2016 e shtypur në ora 21: 56.51, në shumën prej 300 €, tiketa Lavë Baste me numër serik 37214 e datës 14.05.2016, e shtypur në orën 21:57:21, e kanë vërtetuar shumën prej 300 €, ashtu që shuma e përgjithëshme e tyre ishte 1.900,00 €, po ashtu mbrojtjen e të akuzuarit si dhe raportin policor nr.2016-DA-1086 datë 18.05.2016, të përpiluar nga polici B.XH.. Nga deklarata e të dëmtuarit në cilësi të dëshmitarit S.H., gjykata e shkallës së parë drejtë ka vlerësuar se i akuzuari ditën kritike ka shkuar në bastore dhe ka luajtur Reims-Lyon, tiketa e parë ka qenë në shumë që ka kaluar 1.000,00 €, e shtypur nga ana e dëshmitarit-dëmtuarit dhe i njëjti nuk e ka paguar, se gjatë zhvillimit të lojës janë shtypur tri tiketa tjera, live, nga shuma 300,00 €, këto tiketa live nuk kanë mundur të anulohen, se mënyra e pagesës bëhet pas shtypjes së tyre edhe pse tani i dëmtuari fillimisht ka kërkuar nga tani i akuzuari që të paguaj shumën prej 1.000,00 €, për tiketë të shtypur dhe se i akuzuari i ka thënë se paratë i ka në xhep dhe do ti paguaj pastaj, i dëmtuari duke i besuar që i ka paratë ja ka shtypur edhe tri tiketa të tjera. Nga deklarata e të dëmtuarit është vërtetuar se në përfundimin e lojës duke e parë se nuk i ka fituar tiketat, humbjes së bastit i akuzuari është larguar nga bastorja sportive, pa e bërë pagesën në momentin kur i dëmtuari kishte shkuar në tualet dhe pas daljes së tij nga tualeti i akuzuari ishte larguar nga aty gjersa në bastore kishte shumë myshteri, e ndër ta ishte edhe kolegu i tij dëshmitari

A.N.. Bazuar në deklaratat e tani të dëmtuarit dhe dëshmitarit A., të cilat janë identike për këtë pjesë, pas daljes nga tualeti, i dëmtuari e ka vërejte mos prezencën e të akuzuarit në bastore dhe se kolegu i tij A.i e ka njoftuar të njëjtin se tani i akuzuari ka dalë nga bastorja derisa ai ka qenë në tualet, i dëmtuari ka dalë jashtë e ka mbyllur lokalin së bashku me dëshmitarin A.N.n, duke menduar se tani akuzuari është afër bastores, pasi që nuk u vërejt se është aty pari, së bashku kanë shkuar tek vilat e të akuzuarit. I dëmtuari pretendon se e ka thirrë të akuzuarin në telefonin e tij personal, ai është lajmruar në telefon dhe kur e ka ndëgjuar zërin e të dëmtuarit i cili i është prezantuar, i akuzuari menjëherë ia ka ndaluar telefonin. Nga deklarata e dëshmitarit A.N., e dhënë me datë 18.05.2016, në lidhje me çështjen penale gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar se me datë 14.05.2016, në ora 14:00, në bastoren "Toto Sport", kishte ardhur i akuzuari dhe ka luajtur bastore në shumën prej 900 €, ndërsa dy tiketa nga 300 €, një tiketë në shumën prej 200 €, si dhe një tiketë në shumën prej 100 €, dhe pasi ka përfunduar ndeshja i njëjti është larguar nga lokali rreth orës 18:00, për këtë lojë kishte mbetur borxh. I akuzuari është larguar nga lokali dhe ndërkohë rreth orës 20:40 minuta, prap është kthyer i akuzuari dhe e ka paguar shumën prej 900 €, ndërsa rreth orës 20:44 minuta e ka kërkuar shtypjen e një tikete tjetër në shumën prej 1.300,.. €, te i dëmtuari i cili ishte tek kompjuteri. Po ashtu pas shtypjes së tiketës nga i dëmtuari i cili kërkoi paratë të akuzuarit, i njëjti i ka thënë se paratë i ka në xhep dhe do ti paguaj më vonë, i njëjti është ulur për ta përcjellur lojën, ndërkohë i ka shtypur edhe dy tiketa nga 300 €, për të në bastoren Live dhe aty ishte edhe një person tjetër duke shtypur dhe disa persona tjerë. Dëshmitari deklaroi se në ndërkohë i akuzuari ishte larguar pa përfunduar ndeshja, kishte ikur. Nga tiketat e lartëcekura, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar se janë shtypur tri tiketa, ku tiketa e parë në shumën prej 1,300.00 €, tiketa e dytë dhe e tretë në shumën prej nga 300 €, në total në shumë prej nga 1.900,00 €, të trijat tiketat të shtypura në emër të akuzuarit të cilat nuk janë paguar. Gjukata e shkallës së parë pjesërisht ia fali besimin mbrojtjes së të akuzuarit dhe atë se ka frekuentuar bastoren në fjalë disa herë para ngjarjes kritike, ndërsa në pjesën tjetër të deklaratës së tij nuk ia fali besimin ngase ka rënë në kundërshtim me provat tjera materiale si dhe deklaratat e dhëna nga ana e dëshmitarve të lartcekur. Një vlerësim të tillë si të drejtë dhe të ligjshëm e aprovon edhe kjo gjykatë.

Sa i përket vendimit mbi sanksionin penal i akuzuari nuk e ankimon sai përket vendimin mbi sanksionin penal, mirëpo kolegji penal i kësaj gjykate aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e shqyrtoj në këtë drejtim sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës ligjore të nenit 396 të KPPK-së dhe gjeti se nuk ka vend për shqiptimin e një dënimi tjetër nga ai të cilin e ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë.

Kjo gjykatë vlerëson se me të drejtë gjykata e shkallës së parë me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit ka marrë parasysh dhe ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese për të akuzuarin dhe atë konform dispozitës ligjore të nenit 73 të KPRK-së, me ç' rast si rrethana lehtësuese për të akuzuarin, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar faktin se i njëjti nuk gjendet i evindentuar në evindencën penale si dënuar më parë dhe nuk kishte rënë asnjëherë në konflikt me ligjin dhe ndaj të njëjtit nuk zhvillohet ndonjë procedurë tjetër penale, ndërsa si rrethana rënduese për të njëjtin ka gjetur vetë mënyrë kryerjes së veprës penale dhe paligjshmërinë e tij dhe

këmbëngulësinë se nuk është kryes i saj për kundër ekzistimit të provave për veprën penale, kurse rrethanat posaçërisht rënduese gjykata e shkallës së parë nuk ka gjetur.

Vlerësimin e këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se në prani të këtyre rrethanave nuk ka vend për shqiptimin e një dënimi me të butë. Gjkata e shkallës së parë me rastin e marrjes së vendimit për dënim ndaj të akuzuarit, ka vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Kolegji penal i kësaj gjykate, vlerëson se dënimi i shqiptuar, nga gjykata e shkallës së parë ndaj të akuzuarit është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës të kryer penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutor dhe se ky dënim duhet t'i shërbej preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me dënimin e shqiptuar kryerësi do të parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëhet rehabilitimi i tij dhe do të ndikoj në përmbajtjen e personave tjerë nga kryerja e veprave penale, kjo gjykatë konsideron se me dënimin e shqiptuar të akuzuarit nga ana e gjykatës së shkallës së parë do të arrihet edhe qëllimi i ndëshkimit i paraparë me dispozitat e neni 41 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1.nr.196/19, me 18.03.2019

Zyrtari ligjor
Shaban Prekalla

Kryetari i kolegjit - gjyqtari
Gani Zabeli

Anëtarët e kolegjit:

Shqipe Qerimi
Afrim Shala